



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kryeministri

U R D H Ë R

Nr. 71, datë 21.7.2011

PËR

**NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E GRUPIT  
NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS PËR NDJEKJEN  
E PROCEDURAVE TË ANËTARËSIMIT TË SHQIPËRISË  
NË NISMËN PËR TRANSPARENCË NË INDUSTRIJË NXJERRËSE  
(EITI)**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave",

U R D H Ë R O J:

1. Ngritjen dhe funksionimin e grupit ndërinstitucional të punës, për ndjekjen e procedurave të anëtarësimit të Shqipërisë, si vend zbatues i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse, dhe plotësimin në vazhdimësi të detyrimeve të kësaj nisme.
2. Grupi i punës të kryesohet nga zëvendësministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe në përbërje të ketë këta anëtarë:
  - a) Një përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;
  - b) Një përfaqësues nga Ministria e Financave;
  - c) Një përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë;
  - ç) Një përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
  - d) Një përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore;
  - dh) Një përfaqësues nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar;


- e) Pesë përfaqësues nga biznesi, të përzgjedhur nga Rrjeti Kombëtar i Industrisë Nxjerrëse;
- ë) Pesë përfaqësues nga shoqëria civile, të përzgjedhur nga Rrjeti Kombëtar për Shoqërinë Civile për EITI - në.

Niveli i përfaqësimit në këtë grup për institucionet shtetërore do të jetë jo më i ulët se drejtor drejtorie.

3. Me ftesë të kryetarit, në mbledhjet e këtij grupi mund të marrin pjesë përfaqësues nga institucione të tjera.
4. Institucionet e përmendura në pikën 2 të dërgojnë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, pranë kryetarit të këtij grupi, emrat e personave përfaqësues.
5. Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI) përgatit projektin e rregullores për funksionimin e bordit drejtues të sekretariatit të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI), që miratohet nga ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
6. Urdhri nr.156, datë 27.12.2008, i Kryeministrit, "Për ngritjen dhe funksionimin e grupit ndërinstitucional të punës për ndjekjen e procedurave të kandidimit të Shqipërisë në Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI)", shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**



SALI BERISHA